

ORIENTIMI PËR KARRIERËN

Orientimi gjatë studimeve dhe në përfundim të studimeve në AFP duhet të bazohet në **tre parime të rëndësishme**¹:

Orientimi në karrierë

në çdo moment që kërkohet vendimmarrje në momentin e shkëputjes nga institucioni

Shkolla ndihmon nxënësit

për të marrë vendime lidhur me karrierën e tyre për të transferuar njohuritë e tyre në sektorë apo punëdhënës të tjerë

Shkolla këshillon nxënësit

Për të gjetur punën e parë në kompanitë rajonale, në përputhje me njohuritë dhe eksperiencën e nxënësit
Për rritjen e aftësive për t'u vetëorientuar në tregun e punës dhe rritjen e punësimit pas diplomimit.
Për të krijuar ura komunikimi me kompanitë për mundësi punësimi sezonale/internship/punësim afatgjatë

Orientimi për karrierën mbështetet në tre shtylla kryesore:

Informacioni për karrierën

Bazohet në informacionin e tregut të punës;
Tregon për vendin e punës ose tregun e punës për një sektor të caktuar;
Përshkruan gjendjen e tregut të punës në kontekstin e kaluar dhe atë aktual;
Ofron parashikime për të ardhmen.

Edukimi për karrierën

Synon të zhvillojë tek nxënësit kompetencat për zhvillimin e karrierës, e kuptuar si fitimi i njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe sjelljeve për të menaxhuar jetën e tyre, të mësuarit dhe të punuarit në mënyra të E paqarte, ka nevojë të jete me e kuptueshme

Këshillimi për karrierën

Synon t'i ndihmojë nxënësit të aftësohen në planifikimin dhe marrjen e vendimeve të karrierës e jetës së tyre

¹ Marrëdhënia e këshillimit për karrierë me AFP A.G. Watts Instituti kombëtar për edukimin e këshillimin në karrierë, Cambridge, UK www.oecd.org/education/innovation-education/44246616.pdf

Orientimin Në Karrierë Për Shkollat Profesionale

ÇFARË ËSHTË KARRIERA:

Karriera është rruga që bën individi përgjatë shkollës e punës. Gjithnjë e më shumë, ajo po shihet jo si një 'rrugë që zgjidhet', por si një 'rrugë që ndërtohet' përmes një sërë zgjedhjesh lidhur me të mësuarit dhe punën.

Vendimet që të rinjtë marrin gjatë shkollës kanë një ndikim të madh në jetën e tyre, jo vetëm për arsimin e mëtejshëm, trajnimet apo punësimin, por edhe në jetën sociale e gjendjen financiare.

ÇFARË ËSHTË ORIENTIMI PËR KARRIERËN:

Me orientim për karrierën kuptojmë mbështetjen që u japim nxënësve për të qenë më të përgatitur në marrjen e vendimeve lidhur me arsimimin, formimin profesional apo karrierën, bazuar në njohjen e vetes lidhur me interesat, shkathtësitë e aftësitë, si dhe burimet dhe mundësitë e lidhura me to.

ORIENTIMI PËR KARRIERËN DUHET:

Të mbështesë të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe zhvillimin e karrierës

Të nxisë autonominë e nxënësve, duke i ndihmuar ata që të zhvillojnë aftësitë dhe njohuritë që i nevojiten drejt kalimit nga shkolla në botën e punës

ORIENTIMI NË KARRIERË NË SHKOLLAT PROFESIONALE

Funksioni i orientimit për karrierën është pilotuar nga projekti "Aftësi për Punë" si pjesë e Njesisë së Zhvillimit në 6 institucione të ofrimit të AFP, bazuar në ligjin 15/2017.

KUSH janë personat përgjegjës?

Një mësues dhe psikologu i shkollës.
Ata janë trajnuar lidhur me:

- Parimet bazë të orientimit për karrierën
- Instrumentet e vetëvlerësimit
- Informacionin e tregut të punës

KUSH është në fokus të orientimit në karrierë?

- Nxënës e klasave të 9-ta të arsimit të detyruar
- Nxënësit e klasave të 10-ta dhe 11-ta
- Maturantët

SI REALIZOHET ORIENTIMI PËR KARRIERËN?

Orientimi për karrierën bëhet përgjatë 3 fazave:

Para hyrjes në AFP

Gjatë vazhimit të AFP

Në përfundim të AFP, drejt tregut të punës

ORIENTIMI PËR KARRIERËN PARA HYRJES NË AFP

Gjatë procesit të zgjedhjes së drejtimit, nxënësit që përfundojnë klasën e 9-të dhe synojnë drejt shkollave profesionale, duhet që të kenë mbështetjen dhe informacionin e duhur. Një rrugëtim i tillë është gjithnjë më i lehtë dhe më i qartë nëse nxënësit këshillohen, mbështeten dhe orientohen nga:



Si mjete orientuese në procesin e zgjedhjes së karrierës, projekti "Aftësi për Punë" ka përgatitur udhëzues në lidhje me "Profilet dhe Përshkrimet e Kërkesave". Udhëzues të tillë synojnë të ndihmojnë dhe orientojnë të rinjtë në zgjedhjen e karrierës si dhe të kuptojnë aftësitë e tyre në mënyrë të vazhdueshme. Udhëzuesi kërkon të përcaktojë kërkesat kryesore në lidhje me kompetencat e fituara në shkollë, kërkesat fizike dhe kompetencat personale dhe sociale dhe çojnë në një reflektim për dy pyetje:

A mund t'i plotësoj këto kërkesa?

A dua t'i plotësoj ato?

Në ndihmë të nxënësve të klasave të 9-ta, janë përgatitur profilet:

Guidë turistike
Shërbim në bar-restorant
Reception
Kuzhinier
Tregti
Panele diellore dhe hidraulike

Mbështetje për përdoruesit e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit
Zhvillim faqesh interneti
Rrjete të dhënash
Programim
Shërbim elektro-auto